



## PËRMBAJTJE

1. Përmbledhje
2. Hyrje
3. Regjistrimi i Kandidatëve nga Minoriteti Rom dhe Egjiptian në Partitë Politike
4. Vëzhgimi i Zgjedhjeve
5. Pjesmarrja e votuesëve të Minoritetit Rom dhe Egjiptian gjatë fushatës dhe në votime

## 1. Përmbledhje

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon të drejta të plota politike, civile dhe sociale për personat që u përkasin pakicave kombëtare.

Ligji për “Mbrotjen e Pakicave Kombëtare” nr 96/2017 njohu zyrtarisht nëntë pakica kombëtare (Grek, Maqedonas, Arumun, Rom, Egjiptian, Malazez, Boshnjake, Serb dhe Bullgar). Regjistrimi i vitit 2011 renditi më pak se 1.5% të popullatës, si pjesë të një pakice kombëtare; megjithatë, kjo shifër konsiderohet e pasaktë.

Në çdo zgjedhje vendore dhe parlamentare, Institucioni i Komisionit Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ) ka detyrimin të informojë dhe të edukojë popullatën, në këtë rast minoritetet në gjuhën e tyre për procesin elektoral, edukimi konsiston sesi qytetarët duhet të votojnë, rëndësia e votës dhe procesi i pjesmarrjes.

KQZ, me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare, prodhoi një spot ku shpjegon fletën e votimit dhe e ka publikuar në rrjetet sociale të KQZ, ky spot u trasmetua në gjuhën shqipe dhe u titrua në gjuhën e minoritetit Rom, por nuk u trasmetua në asnjë televizion publik apo privat<sup>1</sup>.

Pjesmarrja e votuesëve Rom dhe Egjiptian në zgjedhjet parlamentare të 25 Prill-it 2021, vetëm në 4 bashki (Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Fier) ishte **3577** votues.

---

<sup>1</sup> <https://www.facebook.com/660927020684889/videos/928687157880302>

## 2.Hyrje

Community Reporters Albania është organizatë mediatike jo-fitimprurëse e regjistruar në muajin Tetor 2020 me nr vendimi 1537, në fokusin e saj ka raportimin multimedial në media të shtresave në nevojë për të kërkuar të drejtat e tyre sociale, ligjore dhe për ti fuqizuar ata në media.

Gjatë muajit Prill 2021, qendra përmes një eksperti trajnoi 7 të rinj nga minoriteti Rom dhe Egjiptian për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe përdorimin e teknologjive të reja për raportimin gazetaresk MOJO.

Duke u nisur nga vëzhgimet e kryera në zgjedhjet e kaluara nga OSCE/ODIHR për pjesmarrjen e pakicave kombëtare në procesin e votimit, kanë deklaruar që vota e antarëve të minoritetit Rom dhe minoritetit Egjiptian është cënuar, blerë, shitur dhe vota e tyre nuk ka qenë e lirë.

Ky është **vëzhgimi i parë** që është kryer nga vëzhgues Rom dhe Egjiptian në Shqipëri, me arsyetimin sepse vet komuniteti e njuh komunitetin dhe komunikimi me ata është më i besueshëm dhe i ndërsjelltë.

Vëzhgimi u krye vetëm në 4 bashki ku konsiderohet si popullsia më e madhe e minoritetit Rom dhe Egjiptian, konkretisht në Tiranë(Njësia Administrative nr 1, 4, 5 ,6) Durrës (lagja 14 ose Nishtulla) Elbasan( 5 Maj ose Rrapishtë dhe Lagja “Beqir Dardha) dhe Fier (Levan, Drize, Baltez dhe Mbrostar).

### 3.Regjistrimi i Kandidatëve nga Minoriteti Rom dhe Egjiptian në Partitë Politike dhe programet politike të partive në Shqipëri

Regjistrimi i kandidatëve dhe partive ishte gjithëpërfshirës. KQZ-ja regjistroi 10 parti politike dhe 2 koalicione për të garuar në të gjithë vendin, si dhe 5 kandidatë të pavarur për të garuar në 5 qarqe. Në total, u regjistruan 1,871 kandidatë, duke përfshirë 732 gra (40 për qind).

Në zgjedhjet parlamentare të 25 Prillit 2021, nga minoriteti Egjiptian morën pjesë 4 kandidatë të cilët tre kandidatë u bashkuan në partinë “Nisma Thurje” ku kandiduan në qarkun e Vlorës, dhe 1 kandidate me Partinë “Lëvizja e Re” në votat e tyre janë si më poshtë:

1-Azem Haliti	Partia “Nisma Thurje”	98 Vota
2-Ina Veizaj	Partia “Nisma Thurje”	37 Vota
3-Anisa Aliu	Partia “Nisma Thurje”	0 Vota
4-Dorina Hajdinllari	Partia “Lëvizja e re”	10 Vota

Nga minoriteti Rom, në këto zgjedhje parlamentare nuk pati asnjë kandidat në partitë e politikave.

#### Fushata Zgjedhore për votuesit Rom dhe Egjiptian.

Me 25 Mars 2021 zyrtarisht filloi fushata kombëtare e Partive Politike në Shqipëri, Community Reporters Albania vëzhgoi programet elektorale që partitë paraqiten para votuesëve. Nga vëzhgimet rezultuan se asnjë nga partitë kryesore në Shqipëri nuk ka përmenduar në asnjë fjalë të tyre apo dokument të shkruar fjalën Rom apo Egjiptian, nuk kanë **“premtuar”** asgjë përveç dyfishimin e Ndhmës Ekonomike për familjet e varfëra.

Gjatë takimeve elektorale të zhvilluara përgjatë një muaji rezultoi se asnjë nga tre partitë kryesore nuk zhvilloi takime më anëtarë të minoritetit Rom dhe Egjiptian siç zhvilluan me qytetarë të tjerë në qytete apo lagje të ndryshme. Kjo dukuri u vu në dukje edhe nga organizata të tjera të shoqërisë civile. Organizata “Romano Kham” përmes një projekti ftoi kandidatë nga parti të ndryshme politike për t’u ballafaquar me votuesit Rom dhe Egjiptian, kjo nismë u zbatua në disa qytete në Shqipëri.

Vlen për t’u theksuar se partitë politike nuk kishin në agjendën e tyre takime me minoritetin Rom dhe Egjiptian, dhe i vetmi rast ishte ftesa nga shoqëria civile.



#### 4.Vëzhgimi i Zgjedhjeve

Community Reporters Albania, raportoi për procesin e votimeve për 4 bashki të vendit ku sipas vëzhguesëve pjesmarrja e votuesëve Rom dhe Egjiptian është rreth **3577 votues**.

Nga vëzhgimet që u kryen në terren dhe në qendra votimi sipas vëzhguesëve kemi këto rezultate si më poshtë:

Në qytetin e Tiranës, në Njësitë Administrative 1, 4, 5 dhe 6 rezultojnë se:

- Romët dhe Egjiptianët kanë qenë të painformuar për procesin zgjedhor.
- Persona të ndryshëm kanë shoqëruar pjestarë të minoritetit rom dhe egjiptian për të votuar sipas preferencave të përsoneve të ndryshëm.
- Romët dhe Egjiptianët kanë pasur ndihmë për të votuar.
- Jashtë ambienteve të qendrave të votimit, persona të ndryshëm kanë ndikuar dhe biseduar me anëtarët e minoritetit Rom dhe Egjiptian.
- Gjatë fushatës elektorale persona të ndryshëm kanë paketa ushqimore dhe para cash për të ndikuar tek votuesit.

Në qytetin e Elbasanit në Lagja “5 Maj” dhe Lagja “Beqir Dardha” rezultojnë se:

- Romët dhe Egjiptianët kanë votuar në grupe dhe familjarisht.
- I janë ofruar ushqime dhe para gjatë fushatës elektorale.
- Janë orientuar drejt qendrave të votimit nga persona pa “bagde”

Në qytetin e Durrësit në lagjen “14 Maj” rezultojnë se:

- Romët dhe Egjiptianët kanë votuar në grupe dhe familjarisht.
- Gjatë procesit të votimeve, militantë partie kanë qëndruar duke orientuar votuesit Rom dhe Egjiptian për të votuar.
- Janë shpërndarë ushqime dhe para gjatë fushatës elektorale.

Në qytetin e Fierit, në fshatrat Levan, Drizë, Baltëz dhe Mbrostar rezultojnë se:

- Është blerë vota e votuesëve Rom.
- Janë futur në punë rreth 20 persona gjatë fushatës elektorale.

Sipas vëzhguesëve problematikat mbeten po të njëjta, ku romët dhe egjiptianët i shoqërojnë tek qendra e votimit dhe i udhëzojnë se ku duhet të votojnë, po ashtu votuesit kanë deklaruar se **vota e tyre është shitur**, dhe janë ndikuar nga persona të tjerë nga partitë politike.

Sipas vëzhguesëve, në qytetin e Tiranës, shumica e Romëve dhe Egjiptianëve kanë qenë të pa orientuar dhe kërkonin ndihmë për të gjetur emrat dhe qendrën e votimit. Sipas tyre janë disa persona pa “bagde” i kanë shoqëruar dhe i kanë orientuar se ku duhet të votojnë, raportohet se edhe në qendra të tjera të votimit ka pasur persona pa “bagde” të cilët kanë pritur romët dhe egjiptianët në qendrat e votimit për t’i orientuar për votën e tyre.

Raportohet nga vëzhguesit që banorë rom kanë pasur ndihmë nga shoqëruesit pa “bagde” për të votuar në kutinë e fshehtë, gjithashtu vërehet se në qendrën e votimit ka pasur njerëz të cilët janë ofruar të ndihmojë romët që nuk dinë të lexojnë/

Në Durrës, në lagjen 14 raportohet se në qendrën e votimit ka militantë partie dhe shoqërojnë antarët e minoritetit Rom se ku duhet të votojnë, po ashtu sipas vëzhguesit, pjestarët e komisionit nuk i zbatojnë rregullat.

Në Elbasan, sipas vëzhguesit në lagjen 5 Maj, banorët e minoritetit Rom kanë votuar familjarisht dhe janë orientuar nga persona të tjerë pa “bagde”.

Në Fier, përkatësisht votuesit rom nga Driza, Levani, Mbrostar dhe Baltëz, procesi i votimit ka vijuar me ritme normale, por gjatë fushatës elektorale vota e tyre është blerë në të katërta fshatrat ku banojnë votuesit Rom dhe Egjiptian.

## 5. Pjesmarrja e votuesve Rom dhe Egjiptian gjatë fushatës elektorale dhe zgjedhjeve

Studime të shumta nga organizata ndërkombëtare kanë dëshmuar se niveli arsimor i minoritetit Rom është i ulët, dhe si rrjedhojë në 4 bashkitë që janë vëzhguar, banorë të ndryshëm kanë deklakuar se kanë pasur probleme me leximin dhe kuptimin e fletës së votimit.

Vëzhgimi u krye në 4 Bashki (Tiranë në katër Njësi Administrative 1, 4, 5, 6) (Durrës në lagjen 14) (Fier në fshatin Drizë, Levan, Mbrostar dhe Baltëz) dhe (Elbasan në lagjen 5 Maj dhe Lagja "Beqir Dardha")

<b>Tiranë</b>	<b>900 Rom dhe Egjiptian në 4 Njësi Administrative (1, 4, 5, 6)</b>
<b>Fier</b>	1792 Rom Në 4 Fshatra: Levan, Drizë, Baltëz dhe Mbrostar
<b>Elbasan</b>	215 Rom Lagja "5 Maj" dhe 250 Egjiptian Lagja "Beqir Dardha"
<b>Durrës</b>	420 Rom dhe Egjiptian në Lagjen 14



## 6.Rekomandime

- a. Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve(KQZ) duhet të edukojë popullsinë Rome dhe Egjiptiane duke trasmetuar në gjuhën Rome spote të cilët informojnë dhe orientojnë votuesit për zgjedhjet.
- b. KQZ-ja duhet të informojë në gjuhën e pakicave në televizionin publik gjatë gjithë fushatës.
- c. KQZ-ja duhet të trajtojë persona nga minoriteti Rom dhe Egjiptian për të qenë informues në komunitet.
- d. KQZ-ja duhet të punësojë gjatë fushatës zgjedhore persona nga minoriteti Rom dhe Egjiptian në rolin e anëtarëve të komisionit por edhe punonjës të brëndshëm të cilët do të kryejnë informimin në gjuhën e pakicave.
- e. KQZ-ja duhet të përkthejë materialet informuese dhe fletën e votimit gjatë ditës së votimit në gjuhën e minoritetit Rom, aty ku ka një popullsi të konsiderueshme.
- f. Institucioni i Policisë së Shtetit duhet të garantojë që votuesit Rom dhe Egjiptian të votojnë të lirë, të pacënuar dhe të paintimiduar.